



Kontakti: Ekipi i Zbatimit
Nr. telefonit: 01302 737573
Email: housing.standards@doncaster.gov.uk
Data: 07 Prill 2020

I dashur banor,

KORONAVIRUSI (COVID19): QËNDRIMI I SIGURT NË SHTËPITË ME AMBIENTE TË PËRBASHKËTA

Ne po ju shkruajmë me qëllim që të rrisim ndërgjegjësimin në lidhje me këshillat e rëndësishme aktuale të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për Koronavirusin. Këtë informacion mund ta gjeni në adresën:

https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/877678/coronavirus-leaflet.pdf

Përdorimi i hapësirave të përbashkëta nëse jetoni me persona të tjerë që nuk janë pjesë e familjes tuaj.

Minimizoni kohën që kaloni në hapësirat e përbashkëta si kuzhinat, banjat dhe zonat e ndenjjes sa më shumë që të jetë e mundur dhe mbani hapësirat e përbashkëta të ajrosura mirë.

Përpiquni të ruani një distancë prej 2 metrash (3 hapa) larg nga njerëzit me të cilët jetoni. Nëse mundeni, përdorni një banjë të veçantë nga të tjerët. Sigurohuni që të përdorni peshqirë të veçantë nga njerëzit e tjerë, si për t'u fshirë pas larjes, ashtu edhe për qëllime të higjienës së duarve. Mbajeni peshqirin tuaj në dhomën tuaj.

Nëse ndani tualetin dhe banjën me të tjerë, është e rëndësishme t'i pastroni ato siç duhet çdo herë pasi i përdorni ato (p.sh. duke fshirë sipërfaqet me të cilat keni rënë në kontakt duke përdorur ujë me sapun).

Nëse e ndani kuzhinën me të tjerët, përpiquni ta shmangni përdorimin e saj, ndërkohë që të tjerët janë në të. Nëse është e mundur, merreni ushqimin tuaj në dhomën tuaj për të ngrënë. Përdorni një makinë larëse për enët, nëse keni një të tillë, për të pastruar dhe tharë enët dhe veglat e ngrënies që keni përdorur. Nëse kjo nuk është e mundur, lajini ato duke përdorur sapun të lëngshëm të zakonshëm dhe ujë të ngrohtë dhe thajini plotësisht, duke mos harruar të përdorni një peshqir të veçantë nga ai i të tjerëve dhe vendosini menjëherë në vend. Mos i lini gjërat në anë të thahen.

Ne e kuptojmë se do të jetë e vështirë për disa njerëz të ndahen nga njerëzit e tjerët brenda shtëpisë. Ju duhet të bëni çmos që të ndiqni këtë udhëzim dhe të gjithë në familjen tuaj duhet:

- të lajnë rregullisht duart e tyre me sapun dhe ujë
- të shmangin prekjen e fytyrës së tyre
- të pastrojnë sipërfaqet e prekura shpesh.

Nëse jeni i punësuar dhe nuk keni mundësi të punoni për shkak të Koronavirusit, ju lutemi referojuni udhëzimeve të Departamentit të Punës dhe Pensioneve për të marrë informacion në lidhje me mbështetjen që është në dispozicion për ju.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj në këtë kohë të vështirë dhe ju lutemi monitoroni faqen e internetit të Këshillit për këshilla të përditësuara:

<https://www.doncaster.gov.uk/services/health-wellbeing/coronavirus-covid-19>

Sinqerisht i juaji

P Williams

Paul Williams Menaxheri i Ekipit (Strehimi) – Ekipi i Zbatimit